



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Upgrade Mainserveer” (*Procedure e hapur e thjeshtuar - Mall*)

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.500.000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë, pa TVSH.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Paketa software administrimi 48219300-9

Afati i lëvrimin të mallrave do të jetë **50 (pesëdhjetë) ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përlllogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në nenet 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve për:

- **ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente** për menaxhimin e cilësisë, i cili duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen.
- **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente** për menaxhimin e sistemeve të informacionit, i cili duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen.

- **ISO 27001 : 2022 ose ekuivalente** për menaxhimin e sigurisë së informacionit i cili duhet të përkohet me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, të ndryshuar secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Duke qenë se sistemi pjesë e prokurimit është e rëndësishëm për sigurinë dhe vijueshmërinë e punës të sistemeve kritike në APD duhet që subjektet zbatuese të kontratës të jenë të pajisura me këto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- Përbushja e standartit **ISO 9001: 2015 ose ekuivalente** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.
- Përbushja e standartit **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen dhe që lidhen me mirëmbajtjen e sistemeve. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.
- Certifikimi **ISO 27001:2022 ose ekuivalente** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurtë duke qenë se sistemi përpunon dhe administron informacione dhe të dhëna të rëndësishme dhe sensitive. Ky certifikim garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për programin objekt në këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të leshohet në emër të Autoritetit Kontraktor dhe duhet të përmbajë të dhëna të plota kontakti për të mundësuar verifikimin në çdo kohë nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Gjithashtu, Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kerkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kerkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhuesi të zyrtarizuar. Ky kriter

është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve/punimeve objekt kontrate, duhet të vërtetojë që ka të punësuar të paktën **4 (katër) Inxhinierë/Specialistë** të diplomuar në degët e Inxhinierive dhe/ose Informatikës, të cilët do të angazhohen në implementimin e projektit.

Duhet të ketë në stafin e tij:

- a) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar si menaxher projekti;
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave; Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;
- c) Të paktën 1 (një) specialistë të certifikuar si programues. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikacionesh.

***Shënim:** Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

***Shënim:** Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtetohen me Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

***Shënim:** Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave.

***Shënim:** Kriteret për punonjësit në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomike do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Në rastet kur Operatori Ekonomik do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Argumentimi

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie dhe kërkohet për instalimin sipas kërkesës të produkteve hardware dhe software në objekt të kontratës. Bazuar në VKM nr.189, datë 04.03.2015 “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”, pika 8 gërma “a” specifikohet se aksesimi në këtë zonë lejohet vetëm për personat e certifikuar përshtatshëmrisht dhe të autorizuar specifikisht për të hyrë”.

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti;

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Menaxheret e projektit janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit,

shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Gjithashtu vlen të theksohet që me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për **arsye** të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si DBA (Database Administrator) për administrimin e bazës së të dhënave; Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;**

Argumentimi: Në menyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar si Administrator Database për të përmbushur sa më mirë specifikimet e funksionaliteteve të kërkuara nga ky projekt. Përveç kësaj, punonjësit e certifikuar për DBA nevojiten për të optimizuar performancën e bazës së të dhënave, duke ndjekur praktikat më të mira dhe duke identifikuar dhe eliminuar shkaqet e mosperformancës. Kjo kontribuon në përmirësimin e efikasitetit dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të bazës së të dhënave gjatë gjithë jetës së projektit.

- c) Të paktën 1 (një) specialistë të certifikuar si programues. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga Microsoft/Oracle ose ekuivalente;**

Argumentimi: Në menyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar si programues për të përmbushur sa më mirë specifikimet e funksionaliteteve të kërkuara nga ky projekt. Përfshirja e të paktën një specialisti të certifikuar si programues garanton që zhvillimi i sistemit do të kryhet nga një profesionist me njohuri të verifikuara dhe të standardizuara ndërkombëtarisht. Certifikimet nga Microsoft, Oracle ose ekuivalente dëshmojnë aftësi të avancuara në ndërtimin, strukturimin dhe sigurinë e aplikacioneve. Ky kriter siguron cilësi më të lartë të kodit, efikasitet në zbatim dhe përputhje me standardet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testues aplikacionesh.**

Argumentimi: Punonjësit e certifikuar për testues aplikacionesh kanë njohuri të thellë për metodologjitë dhe mjetet e testimit e aplikacioneve, duke ndihmuar në zbulimin dhe parandalimin e gabimeve që mund të shkaktojnë kosto shtesë për AK. Me punonjës të certifikuar për testimin e aplikacioneve, mund të sigurohemi që projekti është i sigurt dhe siguron mbrojtje të duhur për të dhënat dhe informacionet e përdoruesve. Certifikimi për testimin e aplikacioneve shoqërohet me njohuri të specializuara për mjetet dhe teknologjitë e përdorura në testim. Kjo çon në efikasitet të rritur dhe në zbulimin më të lehtë të problemeve nëpërmjet përdorimit të teknologjive të specializuara. Vendosija e këtij kriteri parashikohet nga AK në mënyrë që produkti përfundimtar që do të dorëzohet të ketë kaluar të gjithë testimet e mundshme të cilat kategorizohen në teste funksionalitetesh, teste sigurie dhe teste përdorueshmërie dhe të jetë validuar nga personel i certifikuar për këtë proces të rëndësishëm.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, për blerjet e reja cilësore, kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e performancë si dhe shërbimet profesionale të kërkuara për teknologjite ekzistuese, ofrimit të produkteve të reja, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.

Specifikimet teknike të procedurës objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për programin në procedurën me objekt “Upgrade Mainserveer”.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.